



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN

DERGUAR ME:
POSILATO DANA: 02.03.2026

NJESIA
JEDINICA NR. KLASIFIKACION
BR. KLASIFIKACION NR. LENDES
BR. PREDMETA SHTOJCA
PRILOG

15-020/08-10608



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

NR	
DATE	02.03.2026
PËR	z. Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL z. Jeton Qela, Sekretar i përgjithshëm në MAPL z. Drin Haraqija, Drejtor i departamentit për Mbikqyrje dhe Përfomancë Lokale z. Kujtim Aliu, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Legjislacionit Lokal z. Nehat Uka, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Legjislacionit Lokal.
KOPJE	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
NGA	z. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal z. Armend Grajqevci, Shef i Grupit LDK z. Arsim Jashari, Shef i Grupit PDK znj. Shahadie Bikliqi Dragaqina, Shefe e grupit LVV
LËNDA	Kërkesë për vlerësimin e mbledhjes së 4-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Të nderuar,

Me datë 26.02.2026, kemi pranuar Shkresën ligjore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr.020-125/1 lidhur me mbajtjen e mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 12.02.2026 përkitazi me monitorimin e kësaj mbledhje nga ana e MAPL-së.

Në shkresën tuaj në mes tjerash keni theksuar se gjatë monitorimit është evidentuar se nuk është miratuar rendi i ditës pasi që Kryesuesi i Kuvendit ka deklaruar se mbyllet mbledhja dhe lidhur me këtë keni konstatuar se çdo veprim i ndërmarrë pas mbylljes së mbledhjes nuk prodhon asnjë efekt juridik.

Në përgjigje të Shkresës tuaj dhe me qëllim të sqarimit lidhur me hapat e ndërmarrë në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Lipjanit të mbajtur më 12.02.2026,

Ju njoftojmë si në vijim:

Pas shpalljes së rezultatit fillestar të votimit për miratimin e rendit të ditës dhe konstatimit se rendi i ditës nuk kishte kaluar, me 14 vota për dhe 15 kundër unë si Kryesues i Kuvendit kam konstatuar të mbyllur këtë mbledhje. Por, menjëher ka ardhur reagimi i anëtarëve të kuvendit nga opozita dhe pozita se ka qenë gabim numërimi i votave nga ana e zyrtarit të kuvendit z.Naser Bytyqi sepse në momentin e votimit në sallë kanë qenë prezent 28 anëtarë dhe se rezultati ka qenë 14 vota për dhe 14 vota kundër. Pas këtij momenti unë si Kryesues kam kërkuar që të marrim 5 minuta pauzë dhe që antarët e kuvendit mos të largohen. Menjëherë pas këtij njoftimi, është bërë verifikimi i saktë i rezultatit të votimit. Pas verifikimit është konstatuar se ka ndodhur gabim në numërim dhe rezultati i saktë i votimit ka qenë 14 vota për dhe 14 vota kundër.

Pas pauzës jemi rikthyer në sallë në kordinim dhe pajtim të plotë me të gjitha grupet parlamentare dhe kemi konstatuar se ka ndodhur gabimi teknik gjatë numerimit dhe me këtë rast edhe i kam dhënë verejtje publike zyrtarit përgjegjës, dhe kemi konstatuar se rendi i ditës ka kaluar me 14 vota për dhe 14 vota kundër duke marrë parasysh votën e dyfishtë që ka në këto raste Kryesuesi i Kuvendit.

Theksojmë se nuk është zhvilluar asnjë votim i ri për rendin e ditës, por vetëm është bërë konstatimi i korigjimit të një gabimi teknik në numërim nga ana e administratës përgjegjëse.

Duhet theksuar se me këtë rast kanë qenë të dakorduar të gjithë anëtarët e kuvendit nga të gjitha grupet dhe se nuk ka pas asnjë kundërshtim nga askush sepse gabimi që ka ndodhë ka qenë faktik.

Pra edhe një herë i gjithë procesi është i dokumentuar përmes transmetimit live dhe incizimit zyrtar, i cili është publikisht i qasshëm në platformën YouTube, dhe që dëshmon qartë rrjedhën faktike të ngjarjes.

Duke marrë parasysh rrethanat e sipërcekura, vlerësojmë se nuk qëndron konstatimi se aktet e miratuara janë të pavlefshme, pasi mbledhja ka vazhduar mbi bazën e një rezultati të saktësuar dhe jo përmes një veprimi të ri procedural të saj.

Kërkojmë nga ana e juaj që të rishikoni vendimin tuaj dhe të merrni parasysh zhvillimet e punimve të kësaj mbledhje duke vlerësuar edhe angazhimin e anëtarëve të kuvendit dhe ekzekutivit të komunës gjatë zvillimit të punimeve të kësaj mbledhje.

Këtë shkresë po ju dërgojmë me mbështetjen edhe të shefave të grupeve në emër të gjitha subjekteve dhe anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Mbetemi të hapur për bashkëpunim dhe sqarime shtesë, në funksion të zbatimit korrekt të legjislacionit në fuqi.

Me respekt,